

Kisha e Shën Kollit në Perondi daton në shekullin XI, thesar i çmuar i trashëgimisë dhe destinacion ndjellës turistik



Shqipëria nuk ka vetëm natyrën, malet mashështore, bregdetin e virgjër, por dhe një trashëgimi kulturore sa vetë jeta që janë një atraksion për turistët vendas dhe të huaj.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore sjell në vëmendje një nga thesaret e çmuar të trashëgimisë sonë, Kishën e Shën Kollit e cila ndodhet në fshatin Perondi, një trashëgimi që flet vetë për turistët vendas dhe të huaj.

Kisha e Shën Kollit ndodhet në fshatin Perondi, rrethi i Kuçovës, rreth 18 km nga

qyteti mesjetar i Beratit dhe përbën një nga monumentet më të hershme bizantine në Shqipëri.

Gjatë shekujve, kisha ka pësuar mjaft transformime në rrafshin arkitektonik. Në vitin 1970 kisha i është nënshtruar një restaurimi të mirëfilltë nga specialistët e Institutit të Monumenteve.

Në fillimet e saj monumenti ka qenë një bazilikë trinefshe me nefin qendror të ngritur lart dhe me narteks dhe sipas studjuesve i përket shekullit të XI. Në një fazë të dytë gjatë periudhës bizantine kishës i është shtuar muri i narteksit dhe këmbanorja, e cila është lidhur organisht me murin e narteksit. Më vonë kisha pëson një meremetim tjetër, ku vihet re përdorimi i teknikës së kluasonazhit. Rindërtim tjetër i rëndësishëm është ai i vitit 1786, ku shtohen hajatet dhe rindërtohen catitë me tavanet.

Po ashtu, Instituti bën të ditur të dhënat historike të rindërtimit të saj.

Rindërtimi i fundit që transformoi së tepërmi arkitekturën e monumentit është në vitin 1931. Më tipike në unikalitetin e saj kisha e Shën Kollit në Perhondi bëhet nëpërmjet këmbanores, e cila mendohet të jetë nga më të hershmet në provincat bizantine të Ballkanit. Megjithë transformimet e shumta në shekujt e kaluar ndërhyrja e specialistëve të monumenteve bëri të mundur që monumenti të rikthehet në identitet dhe të përfaqësojë sot një nga monumentet e kultit bizantin më të spikatur në gjithë rajonin.



— ata.gov.al